



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA  
IZBORNİ PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.362/2025

**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtarët : Bujar Muzaqi kryesues, Hajriz Hoti, dhe Violeta Husaj Rugova anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, kundër subjektit politik Srpska Demokratija, me seli në Mitrovicë të Veriut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 06.02.2025, mori këtë :

**V E N D I M**

**I. PRANOHEN TË BAZUARA** ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, Anr.362/2025 dhe Anr.364/2025 dhe Anr. 365/2025 të datës 04.02.2025, ashtu që subjektit politik Srpska Demokratija, me seli në Mitrovicë të Veriut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjorbë në lartësi prej 4.500.00 Euro (katërmijë e pesëqind) Euro.

**II.** Detyrohet Subjekti politik Srpska Demokratija, me seli në Mitrovicë të Veriut, që gjorbën e shqiptuar si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

**A r s y e t i m**

-Me datë 04.02.2025 PZAP ka pranuar ankesën Anr.362/2025 nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me të cilën pretendon se më datë 04.02.2025, aktivistë të Lëvizjes Vetëvendosje në Zveçan kanë identifikuar banerë/posterë të vendosur në hapësirat/rrugët publike të subjektit politik Srpska Demokratija, në Zveçan në rrugën Kneza Milosa.

- Me datë 04.02.2025 PZAP ka pranuar ankesën Anr.364/2025 nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me të cilën pretendon se më datë 04.02.2025, aktivistë të Lëvizjes Vetëvendosje në Zveçan kanë identifikuar banerë/posterë të vendosur në hapësirat/rrugët publike të subjektit politik Srpska Demokratija, në Zveçan në rrugën Krala Petra 1.

-Me datë 04.02.2025 PZAP ka pranuar ankesën Anr.365/2025 nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me të cilën pretendon se më datë 04.02.2025, aktivistë të Lëvizjes Vetëvendosje në Zveçan kanë identifikuar banerë/posterë të vendosur në hapësirat/rrugët publike të subjektit politik Srpska Demokratija, në Zveçan në rrugën Sutjeska.

Sipas parashtruesit të ankesës me këtë veprim subjekti politik Srpska Demokratija, ka bërë shkelje të nenit 34, paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës-LZP, ku parashihet se *“Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronareve ose shfrytëzuesve.”*

Si provë ka bashkangjitur, fotografit që dëshmon vendosjen e banerave/posterave në kundërshtim me LZP.

PZAP-i me datën 05.02.2025 e njoftoi subjektin politik Srpska Demokratija me ankesat e parashtruara ndaj tyre dhe kërkoi që përgjigjet në ankesë, të dorëzohen deri me datën 06.02.2025 në ora 09:00.

Subjekti politik Srpska Demokratija, nuk ofroi përgjigje në ankesë.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr.01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat A.nr.362/2025, A.nr.364/2025, dhe A.nr.365/2025, të paraqitura me datë 04.02.2025, dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët A.nr.362/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve të parashtruara nga subjekti i njëjtë politik LVV kundër subjektit të njëjtë politik Srpska Demokratija, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankesave.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesat gjeti se:

**-Ankesat janë të bazuara.**

Paneli, nga fotografitë e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë ka konstatuar se subjekti politik Srpska Demokratija, në Zveçan kanë shfrytëzuar jashtëligjshëm dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore hapësirat publike konkretisht duke i vendosur në objektet publike posterat e kandidatit për deputet nga radhët e Subjektit Politik, Demokracia Serbe, Aleksander Arenijevic. Një veprim i tillë është në kundërshtim me nenin 34, paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës LZP, konkretisht neni 34, paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i LZP-së parasheh: *"1. Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjërisë si në vijim:1.2 vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre*

*ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa leje e pronarëve ose shfrytëzuesve.*

Për Panelin këto pretendime janë të pa bazuar, për faktin se posteret janë vendosur në objektet dhe hapësirën publike, dhe se për këtë raste duhet leje e veçantë, përkatësisht, pëlqim nga Drejtoria përkatëse të lëshuar nga Komuna e Zveçanit.

Prandaj, duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se “vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla të palës ankuese janë të qëndrueshme dhe si të tilla i pranoi, sepse kjo shkelje ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit se nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtuesi i ankesës paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e pranoi si të bazuar.

Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se veprimi që përben përsëritje të shkeljes për nga natyra është i njëjtë apo ngjashëm, subjektit politik që ka bërë shkelje të legjislacionit zgjedhor, që konsiston në faktin se subjekti politik Srpska Demokratija, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1, dhe neni 120 paragrafi 1 nen parafi 1.3, të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**

Anr.362/2025 më datë 06.02.2025



***KËSHILLA JURIDIKE:*** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.